

Një tjetër vepër e shpëtuar, përfundon restaurimi i ikonës “Shën Joan Pagëzori”



Qendra muzeore Berat sapo ka përfunduar ndërhyrjen restauruese të ikonës “Shën Joan Pagëzori” e vitit 1835, që mban firmën e Naum Çetirit.

Lajmi u bë i ditur nga ministrja e Kulturës, Elva Margariti, e cila theksoi se “pas një muaji pune intensive, ajo i shtohet ekspozimit ikonografik në muzeun “Onufri””.

“Vepra paraqiste shumë problematika, por pas ndërhyrjes u arrit rezultati i dëshiruar, duke nxjerrë në dukje ngjyrat e ikonës, freskinë dhe madhështinë e veprës. Ajo pasuron jo vetëm koleksionin e muzeut “Onufri”, por plotëson kronologjinë në artin e autorëve ikonografë Çetiri”, – theksoi Margariti.

— ata.gov.al